



Nr. Ref. BD-213/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M


- I. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 30 shtator 2024, 15 tetor 2024 dhe asaj të jashtëzakonshme me 21 tetor 2024 nëpërmjet këtij vendimi aprovohen si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtura me 30 shtator 2024, 15 tetor 2024 dhe asaj të jashtëzakonshme me 21 tetor 2024. Dokumentet aprovoheri në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/2

Në bazë të neneve Neni 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për shitjen e aseteve në likuidim dhe Procedurave të shitjes për shitjen e aseteve në likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. Aprovohet lista e aseteve për shitje në ShAL 70 me gjithsej 29 asete dhe me gjithë depozitat e propozuara.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të listës së aseteve për Shitje të Aseteve përmes Likuidimit ShAL 70. Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, AKP ka zotësi të plotë juridike, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.


Në këtë kontekst një ndër detyrat themelore të Agjencisë është procesi i shitjes së pronave shoqërore në mbarë territorin e Kosovës dhe jashtë sajë. Ndër format e shitjeve që i përdorë Agjencia Kosovare e Privatizimit është shitja përmes tenderit publik dhe atë kryesisht nëpërmes grupimit të aseteve në Shitje të Aseteve përmes Likuidimit (ShAL).


Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024.


  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Regjioni	Nr. i asistive	Tokë bujqësore	Tokë ndërtimore	Total	Kategoria e asitit	Hëmbëzgjatja e asitit	Klasa e Tokës	Përshkrimi i shkurter i asitit	Komuna	Lokacioni (Rr./K. Qend.)	Randome	Shtepësiqja e objektit m <sup>2</sup>	Sipërfaqja totale m <sup>2</sup>	Depozita e ofrimit Verifikuar (Euro)	Aksi i referencës së kësaj asistive me qëllim të përmbajtjes së tokës	Aksi për të cilin asistive janë investuar	Vërejtje	Riservimet
Gjirin	0	0	0	0	0	0	0	0										
Mitrovica	1	0	0	1	0	0	0	0										
Peja	2	0	0	1	0	0	0	1										
Prishtina	26	0	0	0	0	0	0	0										
Prizren	0	0	0	0	0	0	0	0										
Gjithsëj	29	0	0	2	0	0	0	1										

Nr	Regjioni	AKP ID	Emili i SHK-së	Fl. Nr.	Emili i Asitit	Kategoria e asitit	Hëmbëzgjatja e asitit	Klasa e Tokës	Përshkrimi i shkurter i asitit	Komuna	Lokacioni (Rr./K. Qend.)	Randome	Shtepësiqja e objektit m <sup>2</sup>	Sipërfaqja totale m <sup>2</sup>	Depozita e ofrimit Verifikuar (Euro)	Aksi i referencës së kësaj asistive me qëllim të përmbajtjes së tokës	Aksi për të cilin asistive janë investuar	Vërejtje	Riservimet
1	Peja	FU127	NHTT Prishtina	FL 445/58	Motel Dreni Barok	Objekt	Objekt i Fortë		Restorant dhe objektet përqisore në sipërfaqe 579 m <sup>2</sup> sipas matjeve të SHK-së dhe 1520 m <sup>2</sup> sipas të vertetës. Toka ku ndodhen objektet NHT është pronë e shpirtë.	Gjakovë	Ujë	599.24	599.24	5,000.00	1			Toka ku ndodhin objektet evidentohet në emër të SHK-së dhe është pronë e SHK-së. Objektet për të cilët është propozuar NHT janë objektet për të cilët është propozuar NHT dhe objektet për të cilët është propozuar NHT. Toka ku ndodhen objektet NHT është pronë e shpirtë. NHT është pronë e shpirtë dhe është pronë e shpirtë. NHT është pronë e shpirtë dhe është pronë e shpirtë. NHT është pronë e shpirtë dhe është pronë e shpirtë.	
2	Peja	FU135	Erekuva - Tregëta	FL 450/89	toka në Rr. Muga 29/m. Gjakovë	Lotaj	Objekt i përbërë		toka në sipërfaqe 79 m <sup>2</sup> sipas matjeve të SHK-së dhe 100 m <sup>2</sup> sipas të vertetës.	Gjakovë	Gjakovë	79.00	79.00	€3,000.00	1	1		Toka ku ndodhet objekti i shkurter evidentohet në emër të SHK-së Komunal Gjakovë.	
3	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1772-2	Tokë bujqësore	arë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1772-2 me sipërfaqe 1962 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		1,962	€15,000.00	1			Ngritja 1772-2 kufizohet me ngatira private	
4	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1782-2	Tokë bujqësore	arë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1782-2 me sipërfaqe 404 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		4,04	€20,000.00	1			Ngritja 1782-2 kufizohet me ngatira private	
5	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1785-0	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1785-0 me sipërfaqe 681 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		6,81	€20,000.00	1			Ngritja 1785-0 kufizohet me ngatira private	
6	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1815-6	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1815-6 me sipërfaqe 1658 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		1,658	€15,000.00	1			Ngritja 1815-6 kufizohet me ngatira private	
7	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1909-0	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1909-0 me sipërfaqe 492 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		4,92	€20,000.00	1			Ngritja 1909-0 kufizohet me ngatira private	
8	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1937-0	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1937-0 me sipërfaqe 311 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		3,11	€20,000.00	1			Ngritja 1937-0 kufizohet me ngatira private	
9	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1901-2	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1901-2 me sipërfaqe 3897 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		3,897	€20,000.00	1			Ngritja 1901-2 kufizohet me ngatira private	
10	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 288-0	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 288-0 me sipërfaqe 3317 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		3,317	€20,000.00	1			Ngritja 288-0 kufizohet me ngatira private	
11	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 203-0	Tokë bujqësore	arë	2	Tokë bujqësore, parcelë 203-0 me sipërfaqe 230 m <sup>2</sup>	Gracanë	Llapashtë		2,30	€15,000.00	1			Ngritja 203-0 kufizohet me ngatira private	
12	Prishtina	FRN115	Ratar	FL 820/89	Ratar Tokë Bujqësore Llapashtë - 1155-0	Tokë bujqësore	arë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1155-0 me sipërfaqe 2447 m <sup>2</sup>	Prishtinë	Çafëzë		2,447	€15,000.00	1			Ngritja 1155-0 kufizohet me ngatira private	
13	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore Kruhç VI	Tokë bujqësore	arë	1	Tokë bujqësore, parcelë 107-0 me sipërfaqe 659 m <sup>2</sup>	Lipjan	Kruhç		6,59	€15,000.00	1			Ngritja 107-0 kufizohet me ngatira private	
14	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore në Lipjan I	Tokë bujqësore	arë	2	Tokë bujqësore, parcelë 130-0 me sipërfaqe 422 m <sup>2</sup>	Lipjan	Lipjan		4,22	10,000.00	1			Ngritja 130-0 kufizohet me ngatira private	
15	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore në Lipjan IV	Tokë bujqësore	arë	3	Tokë bujqësore, parcelë 130-0 me sipërfaqe 184 m <sup>2</sup>	Lipjan	Lipjan		1,84	10,000.00	1			Ngritja 130-0 kufizohet me ngatira private	
16	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore në Lipjan VI	Tokë bujqësore	arë	5	Tokë bujqësore, parcelë 165-1 me sipërfaqe 252 m <sup>2</sup>	Lipjan	Lipjan		2,52	10,000.00	1			Ngritja 165-1 kufizohet me ngatira private	
17	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore në Shtetë - 2200-0	Tokë bujqësore	arë	4	Tokë bujqësore, parcelë 2200-0 me sipërfaqe 248 m <sup>2</sup>	Lipjan	Shtetë		2,48	5,000.00	1			Ngritja 2200-0 kufizohet me ngatira private	
18	Prishtina	FRN115	KB Kosova	FL 107/90	KB Kosova Tokë Bujqësore në Shtetë V	Tokë bujqësore	arë	4	Tokë bujqësore, parcelë 157-0 me sipërfaqe 476 m <sup>2</sup>	Gracanë	Shtetë		4,76	10,000.00	1			Ngritja 157-0 kufizohet me ngatira private	



Handwritten initials 'MHA' in the top right corner of the page.



Nr	Regjioni	AKP ID	Emri i SHK-së	Fl. Nr.	Emri i Asetit	Kategoria e asetit	Nënkategoria e asetit	Klasa e Tokës	Permbajtja i shkurtruar i asetit	Komuna	Lokacioni (Fshat, Qytez)	Rozetuesi	Sipërfaqja e objektit m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e tokës m <sup>2</sup>	Drejtuesi i objektit i asetit	Aseti i referuar në ligjin e rregullimit të pronës së shtetërore ose në ligjin e rregullimit të pronës së bashkëpunëtorëve	Aseti për të cilin ka pasur probleme juridike të tjera investuesit	Vlerë e	Ditë e kaluar
19	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Livazhë - 1004.2	Tokë bujqësore	atë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1004.2 me sipërfaqe 4950m <sup>2</sup>	Grapshtë	Livazhë		4,945	10,000				Nëgatra 1806-2 bujqësori me ngatira private	
20	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Livazhë - 2120.1	Tokë bujqësore	atë	5	Tokë bujqësore, parcelë 2120.2 me sipërfaqe 3042m <sup>2</sup>	Grapshtë	Livazhë		3,044	10,000				Nëgatra 1220-2 bujqësori me ngatira private	
21	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Subadoll - 431-10	Tokë bujqësore	atë	10	Tokë bujqësore, parcelë 431.10 me sipërfaqe 1955m <sup>2</sup>	Grapshtë	Subadoll		1,955	5,000				Nëgatra 431-10 Gender Ater ngatira do-1 e cilës është pronë e KSH KB Kosova, marrësi në ngatira do-1 ka marrësi dhe është në bashkëpunëtorë DO-1	
22	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Subadoll - 831-0	Tokë bujqësore	livadh	2	Tokë bujqësore, parcelë 831.0 me sipërfaqe 3605m <sup>2</sup>	Grapshtë	Subadoll		3,605	10,000				Nëgatra 831-0 bujqësori me ngatira private	
23	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1034.0	Tokë bujqësore	atë	3	Tokë bujqësore, parcelë 1034 me sipërfaqe 1332m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		1,332	5,000				Nëgatra 1034-0 bujqësori me ngatira private	
24	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1159-0	Tokë bujqësore	atë	2	Tokë bujqësore, parcelë 1159.0 me sipërfaqe 3791m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		3,791	10,000				Nëgatra 1159-0 bujqësori me ngatira private	
25	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1270-1	Tokë bujqësore	atë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1270.2 me sipërfaqe 3800m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		3,800	10,000				Nëgatra 1270-2 bujqësori me ngatira private	
26	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1298-1	Tokë bujqësore	atë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1298.1 me sipërfaqe 3203m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		3,203	10,000				Nëgatra 1298-1 bujqësori me ngatira private	
27	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1311-0	Tokë bujqësore	atë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1311.0 me sipërfaqe 4586m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		4,586	15,000				Nëgatra 1311-0 bujqësori me ngatira private	
28	Prishtinë	PN032	KB Kosova	FL07/90	KB Kosova Tokë bujqësore në Guhterëcë e Fashinës - 1311-0	Tokë bujqësore	atë	4	Tokë bujqësore, parcelë 1311.0 me sipërfaqe 2445m <sup>2</sup>	Grapshtë	Guhterëcë e Fashinës		2,445	10,000				Nëgatra 1311-0 bujqësori me ngatira private	
29	Mitrovica	MIT07/9	Lux	FL2006/9	LUX Turketen	total	Objekt		Objekt i kusur i vlerësuar në 1200000 Euro, sipas kësaj vlerësimi ka sipërfaqe prej 28m <sup>2</sup> , ndërsa sipas matjeve në terren ka sipërfaqe 34 m <sup>2</sup> .	Mitrovica e Jugut	Mitrovica e Jugut	34		€ 1,500			Vetëm objekt i caktuar sipas të dhënave		



MA





Nr. Ref. BD-213/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe Nenit 43.6 i Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencive të Pavarura, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti i Agjencisë për periudhën 01 korrik – 30 shtator 2024.
- I. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të Raportit tre mujor TM3-2024 (korrik, gusht, shtator) të Agjencisë, që duhet të dërgohet në Kuvend të Kosovës.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencive të Pavarura në mars 2019, raportimi 3 mujor i kërkuar me 22.03.2022 nga Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti si Komision përgjegjës është në pajtueshmëri me nenin 43.6 të të njëjtit Ligj i cili parasheh sikurse në vijim: përveç raportit vjetor sipas paragrafit 5 të këtij neni, Agjencia paraqet, gjithashtu, raporte për periudha më afatshkurtra apo raporte për çështje të posaçme, nëse kërkohet nga komisioni përgjegjës, gjë që Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka paraqitur kërkesë të tillë për raportim 3 mujor me datë 22.03.2022.

Duke qenë se Kuvendi është organi më i lartë ligjvënës në Kosovë dhe se është themelues i Agjencisë dhe organ të cilit Agjencia i përgjigjet/raporton dhe duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/4

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: \_\_\_\_\_, ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ (tani i ndjerë), me numër KB-1332/15 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: N.N. Ramiz Sadiku, Prishtinë PRN035.
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: parashtrues i kërkesës: \_\_\_\_\_, ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ (tani i ndjerë), për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: N.N. Ramiz Sadiku, Prishtinë PRN035. Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/5

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: me KB-1803/24 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Gërmia" Prishtinë (PRN093).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës , për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Gërmia" Prishtinë (PRN093). Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/6

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës \_\_\_\_\_, ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ me numër KB-1722/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Jugoazbest, Fabrika Alata", Ferizaj (GJI055).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


## ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës \_\_\_\_\_, ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Jugoazbest, Fabrika Alata", Ferizaj (GJI055). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon vendim mbi ndarjen e banesës, dhe nga përgjigja e Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kërkesa e palës ne fjale ju është hedhur poshtë me Vendim HPCC/D/181/2005/AV i datës 30.04.2005, andaj Komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1, nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86), si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-061, për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore. Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/7

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës (përmes zyrës për ndihmë juridike në Graçanicë) me numër KB-1743/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Prizren -Prevoz" Prizren (PRZ047).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Prizren -Prevoz" Prizren (PRZ047). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës (përmes të autorizuarit me numër KB-1745/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Kosmet Export" (PRN141).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Kosmet Export" (PRN141). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Vendim mbi ndarjen e banesës dhe Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente për kërkesën me numër KB-1808/24 e parashtruar nga \_\_\_\_\_ ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 10.10. 2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Kuvendi Komunal" Prizren.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 10.10.2024 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës \_\_\_\_\_ - përmes të autorizuarit Avokat \_\_\_\_\_, ku bartës i të drejtës banesore është \_\_\_\_\_ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga nga "Kuvendi Komunal" Prizren.


Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik nga "Kuvendi Komunal" Prizren nuk është NSh dhe nuk bie nën jurisdikcionin administrativë të Agjencisë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/10

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 23.09.2024 lidhur Ndërmarrjen Kopaonik Leposavic-Kosovë KPS 1545-MIT129, sipas së cilit konstatohet se ndërmarrja bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe dëshmitë të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se Ndërmarrja Kopaonik Leposavic-Kosovë konform nenit 5 të ligjit të lartcekur të Agjencisë, bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.


Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/11

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 02/2024 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet transferimi i kontratës së qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist me sipërfaqe prej 310 m<sup>2</sup>, pronë e NSh Jatex nga subjekti "Flamur Efendija" B.I tek tek Kompania "Simple Plus" sh.p.k, përfaqësuar nga Adea Efendija.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dpër transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet sikurse nw vijim:

Qiramarrësi i aseteti të Ndërmarrjes Jatex, "Flamur Efendija" B.I. ka me qira lokalin afarist me sipërfaqe prej 310 m<sup>2</sup>, në vlerë prej 616.21€ i cili gjendet në Gjakovë.


Me datë 9 tetor 2024 menaxhemti i NSh "Jatex" ka kërkesën e qiramarrësi Flamur Efendija B.I. lidhur me transferim të kontratës së qirasë tek subjekti "Simple Plus" sh.p.k. Arsyeja e transferimit të kontratës së qirasë është se qiramarrësi Flamur Efendija është i inkuadruar në Institutin e Mjekësisë së Punës dhe i sistemuar në vendin e punës Zyrtar Zotues në Buxhet dhe Financa, që nënkupton bashkëpunim me Thesarin e Shtetit. Kërkesën qiramarrësi e arsyeton se personat e angazhuar në pozita të tilla nuk kanë të drejtë të hapin biznes në emrin e tyre, andaj ka kërkuar që pas skadimit të kontratës së qirasë me date 31.10.2024 ti mundësohet vazhdimi i kontratës së qirasë me subjektin "Simple Plus" sh.p.k. me nr. të biznesit 812121341 me përfaqësues Adea Efendija (e bija).


Me datë 10/10/2024, Bordi i NSh "Jatex" ka mbajtur mbledhjen dhe në bazë të dokumentave të prezantuar nga qiramarrësi ka marr vendim të aprovoj kërkesën e Flamur Efendija, biznes individual "Flamur Efendija". Sipas vlerësimit të Divizionit të Kontrollit dhe Administrimit Direkt, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
\_\_\_\_\_  
**Mentor Hyseni**  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/12

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit të rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 18.10.2024 të ndërmarrjeve nën Administrim Direkt, sipas listës së bashkangjitur.
- II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin të rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 18.10.2024 të ndërmarrjeve nën Administrim Direkt, sipas listës së bashkangjitur.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore (pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo) me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e datës 18 Tetor 2024

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së/njësia	Emri i Ofruesit me ofertën më të lartë	Lloji i asetit	Qiradhënie Mijore/Vjetore	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DE mbli themelimit e Komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira	Cmimi më i lartë i qiradhënies paraqitur ose Tenderimit të fundit	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit për m <sup>2</sup>	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m <sup>2</sup>	Cmimi i ofertës më të lartë	Numri i Ofertave	Vendimi Bordit	A ka të agathuar momentalisht sigurim për asetin PO/IO	Shuma mujore e pagesës së sigurimit të asetit	Koment / Vrejtjeje
1	AD	Hapësirë reklamuese Teleferiku "Qafa e Uanit" Teleferiku "Livadhli i madhë" Stacioni i nisjes së teleferikut Hotel Molika: Stacioni i nisjes së automejeteve, Zona reklamuese	Rifat Blytyqi	Hapësirë Reklamuese	Qiradhënie Vjetore	Qendra e Skijimit Brezovica	DE 436/2024	2	14.410.16 për 6 muaj	Hapësirë reklamuese	3.91	2.52	21.564	5	Aprovim	JO		Hapësirë Reklamuese Në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi
2	AD	Lokali Afarist, Restoranti "Expres" Hapësirë afariste që gjendet në objektin e Hotel "Molika".	Hekuran Kuci	Lokal	Qiradhënie Mujore	Hotel "Molika" Qendra e Skijimit Brezovica.	DE 436/2024	2	1.316	336.80	3.91	2.52	850	7	Aprovim	JO		Komisioni ka marrë në konsideratë çmimin e qiradhënies paraqitur prej 1.316 euro/muaj, ka rekomanduar REFUZIMIN e ofertes prej 850 euro/muaj në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi
3	AD	Objekti Afarist, Villa "Partizanka" Gjendet në Qendrën e Skijimit, ngjarje me stacionin e nisjes së teleferikut "Livadhli i Madh", përbërë nga restorant, kuzhinë dhe tualet në katin përfaqësues, katër dhoma në katin e parë dhe dy dhoma gjumi në nën kullm.	Durim Sylejmani	Objekti	Qiradhënie Mujore	Qendra e Skijimit Brezovica.	DE 436/2024	1		151.90	2.47	13.23	2.010	11	Aprovim	JO		Në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi
4	AD	Lokali Afarist "Ski Bye" (Ndërtesa prej Druri) ndodhet në hyrje të Qendrës së Skijimit.	Atthe Abazi	Lokal	Qiradhënie Mujore	Qendra e Skijimit Brezovica.	DE 436/2024	1		35.70	4.85	27.73	990	11	Aprovim	JO		Në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi
5	AD	Objekti Afarist, Hotel "Brez"	Rexhep Bilimli	Objekti	Qiradhënie Mujore	Zona Kadastrele Verëbeshitë	DE 436/2024	1		Objekt 2,500 m <sup>2</sup> dhe toke 9,260 m <sup>2</sup>			4.010		Aprovim	JO		Në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi
6	AD	Lokali/depo e cila ndodhet në kompleksin e Ndërmarrjes Jatek	Driton Poshegu	Lokali/Depo	Qiradhënie Mujore	Brr. Mëna Terestë nr. 8, Gjakovë	DE 435/2024	2	250	300	1.21	1.37	412	3	Aprovim	JO		Në kuader të ndërmarrjes janë të agathuar sigurimi







Nr. Ref. BD-213/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10.1.4 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte për lokalin afarist me sipërfaqe prej 49 m<sup>2</sup> për parashtruesin e kërkesës Poliklinika "Fati" përfaqësuar nga Fatmir Idrizi sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 184.00 Euro/muaj për asetin e NSH Gërmia PRN093.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qirasë direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 31.07.2024 ZQ Prishtinë ka pranuar kërkesën me numër protokollit 5403/2024 nga Poliklinika "Fati" i cili ka shprehur interes të marr me qira asetin e lartpërmendur.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 377/2024 të Drejtorit Ekzekutiv ka bërë përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist në sipërfaqe prej 49 m<sup>2</sup> është në shumën prej 184.00 Euro/muaj. Aset/lokali ndodhet në rrugën "Vlode Cetkovic" në Mitrovicë të Veriut.


Siç mund të vërehet në bazë të kërkesës, pala ka siguruar letër mbështetëse nga ana e autoriteteve lokale të KK Mitrovicë Veriore, mbështetje kjo e argumentuar me faktin se qiramarrja në këtë rast do të ndikonte në zhvillimin e biznesit në fjalë dhe komunitetit përreth.


Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 2.5 të kontratës bazë të qirasë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës Xhavit Hykasmoni për transferimin e Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e tokës saktësisht sipërfaqen prej 300m<sup>2</sup> nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.2349 dhe sipërfaqen prej 370m<sup>2</sup> ngastrës kadastrale nr.2350 në sipërfaqe të përgjithshme prej 6ari 70m<sup>2</sup> nga Mehmet Hykasmoni tek Xhavit Hykasmoni me qira vjetore prej 25.00 EUR/vit për pronën e NSH KB Moronica.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Mehmet Hykasmoni ishte Qiramarrës i tokës bujqësore sipas kontratës me NS KB Moronica, konkretisht sipërfaqen prej 300m<sup>2</sup> nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.2349 dhe sipërfaqen prej 370m<sup>2</sup> ngastrës kadastrale nr.2350 në sipërfaqe të përgjithshme prej 6ari 70m<sup>2</sup>, fleta poseduese nr.6-951-854, me nr. të kontratës 3337-2016 të dt. 20.12.2016. Familjarët e tij ende janë duke e shfrytëzuar të njëjtën tokë bujqësore sipas Aneks Kontratës nr.1930-2023 të dt.13.12.2023 për periudhën kohore 01.12.2023 - 30.11.2024.

Pasi që z. Mehmet Hykasmoni ka ndërruar jetë më datë 17.01.2024, z. Xhavit Hykasmoni djali i të ndjerit i cili ka jetuar në bashkësi familjare me babain ka kërkuar që të bartet kontrata në emrin e tij.

Parcelat nr.2349 është dhënë pjesërisht me qira (sipërfaqja e dhëne 300m<sup>2</sup> prej 1130m<sup>2</sup>) dhe 2350 në sipërfaqe prej 370m<sup>2</sup> ZK Junik me sipërfaqe të përgjithshme të pronës së dhëna me qira prej 6ari 70m<sup>2</sup>, në këtë parcelë pjesërisht janë ndërtuar shtëpitë si dhe parcela përdoret si oborr apo kopshtet të cilat lidhen me pronën private të qiramarrësit (shih aeroimazhin). Ngastrat kadastrale janë me kulturë Arë kl.3 në pronësi PSH Kooperativa Bujqësore Moronica, se bashku janë në sipërfaqe prej 1500m<sup>2</sup> dhe vetëm sipërfaqja prej 670m<sup>2</sup> ishte objekt i vlerësimit pasi që kjo pjesë është rrethuar me rrethoja teli dhe shtylla druri dhe në shfrytëzim si oborr, pas vlerësimit të çmimit të tregut për sipërfaqen totale prej 670m<sup>2</sup> është lidhur një (1) kontratat e qirasë.

Kontrata bazë e qirasë nr. 3337/2016 e dt. 20.12.2016 është lidhur në bazë të vendimit DM 261-2016 mbi formimin e Komisionit për hulumtimin/vlerësimin e çmimit të tregut në lidhje me qiradhënien e pronës së KB Moronica në Junik- konkretisht sipërfaqen prej 300m<sup>2</sup> nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.2349 dhe sipërfaqen prej 370m<sup>2</sup> ngastrës kadastrale nr.2350 në sipërfaqe të përgjithshme prej 6ari 70m<sup>2</sup> në ZK Junik.

Lidhur me ngastrat të cilat janë marrë me qira (si dhe me ngastrat tjera të ZK Junik) nga AKP me dt. 21.01.2013 është parashtruar padia për dorëzim në posedim ku gjithashtu dhe z. Mehmet (Musë) Hykasmoni ishte i paditur, për këtë lëndë janë zhvilluar seancat gjyqësore pranë Gjykatës Themelore Pejë (C.nr.83/13) për të cilën e njëjta është shpallur jokompetente për shkak të vdekjes së njërit nga të paditurit, prandaj me dt. 01.04.2015 pranë GJTH Pejë nga AKP është parashtruar parashtrëse për zgjerimin e padisë në të cilën nuk është zhvilluar ndonjë seancë.

MH





Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe të mbetura pasi që ka paguar qiranë vjetore nga momenti i lidhjes së kontratës e deri në vitin 2024, e njëjta do të mundësojë rritjen e fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore si dhe ruajtjen e pronës sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e qerasë.


Ky aset nuk është në listën e aseteve të dedikuara për Fondin Sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik.

Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Neni 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 2.5 të kontratës bazë të qirasë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e D.P.H. Chelsea me përfaqësues Mithat Hamza për pezullim/mos-faturim në bazë të kontratës së qirasë së vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokollit 1553/2024 të datës 31.07.2024 për lokalit afarist me sipërfaqe prej 18 m2 deri në përfundimin e punimeve nga ana e KK Pejë për pronën e NSH "Agrodukagjini".
- II. Obligohet Zyra Rajonale Pejë që kohë pas kohe të bëjë vizitën në terren dhe verifikimin se kur përfundohen punimet dhe pas kësaj të konsiderohet se pushon efekti i pezullimit të kontratës së qirasë dhe të vazhdohet me faturim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për pezullimin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

D.P.H. Chelsea me përfaqësues Mithat Hamza është qiramarrës i lokalit afarist në sipërfaqen prej 18 m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokollit 1616/2015 të datës 03/06/2015, të vazhduar së fundmi me aneks kontratën e qirasë me nr. protokollit 1553/2024 të datës 21.07.2024 në shumën totale prej 125.00 Euro/muaj. Lokali afarist i lëshuar me qira ndodhet në "korzën" e Pejës apo në sheshin e Pejës dhe kësaj KK Pejë ka filluar punimet në këtë pjesë dhe ju ka pamundësuar ushtrimin e veprimtarisë të gjithë lokaleve që ndodhen në atë pjesë të sheshit të Pejës. Si rrjedhojë më datë 30.09.2024 pala qiramarrëse ka parashtruar kërkesë që të bëhet pezullimi i kontratës së qirasë sepse lokali nuk do të mund të jetë funksional dhe nuk do të mund të operojë për një afat të pacaktuar deri në përfundimin e të gjitha punimeve në atë pjesë.

Për më tepër, më datë 10.10.2024 pala qiramarrëse ka sjellur edhe një njoftim nga ana e KK Pejë, përmes të cilit është njoftuar që në pjesën ku gjendet lokali afarist i lëshuar me qira kanë filluar punimet për ndërtimin e sheshit të ri dhe se me qëllim të realizimit të punimeve në kushte të sigurta dhe efektive, gjatë zhvillimit të punimeve lokalet në këtë pjesë nuk do të mund të operojnë. Sipas njoftimit nga ana e KK Pejë kjo ndërprerje e ushtrimit të veprimtarisë do të zgjasë përkohësisht deri në përfundimin e punimeve në sheshin e ri. Edhe në bazë të raportit të vizitës në terren të datës 23.10.2024 vërehet që në zonën ku ndodhet lokali afarist kanë filluar punimet dhe se shumica e bizneseve në atë pjesë si pasojë e punimeve janë mbyllur, përfshirë edhe lokalit të cilin pala e ka me qira nga ana e NSH "Agrodukagjini".

Sipas vlerësimit të AL-së, pezullimi dhe mos-faturimi i kontratës së qirasë për periudhën sa do të zhvilloheshin punimet pranë lokalit afarist të NSH "Agrodukagjini" është i arsyeshëm dhe kjo nuk do të paraqiste ngarkesë për palën qiramarrëse apo edhe rritje të borxhit ndaj NSH-së.





Në rast të kundërt, nëse kjo kontratë qiraje nuk do të pezullohej dhe pala do të vendoste të mos e mbante atëherë për periudhën sa janë duke u zhvilluar punimet vështirë se do të mund të lëshohej me qira.


Poashtu, pezullimi është i arsyeshëm edhe mbi faktin që në bazë të investimeve të bëra nga pala qiramarrëse vlera e lokalit afarist është rritur. Ky aset nuk është në listën e asetëve të dedikuara për Fondin Sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/16

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:
- Lokali nr.15 me sipërfaqe 14.01<sup>2</sup> - Tregu i Gjellbër (te RTK) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 117.00 € për një muaj për parashtruesen e kërkesës Konsoni M SH.P.K përfaqësuar nga Agim Sahiti;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 13.09m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr. 621 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 26.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Amir Krasniqi;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 26.62m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 692 dhe 559 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 52.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Arben Sada ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 29.62m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 691 dhe 660 Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 58.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Habib Shala ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 27.40m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr. 701 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 54.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Gazmend Lepaja;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 56.38 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 689 dhe 690 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 110.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Gazmend Lepaja ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 27.74 m<sup>2</sup>, 13.26 m<sup>2</sup> dhe 13,26 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 663, 664, 687 dhe 688 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 106 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Skender Rukovci;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 26.93m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 683 dhe 684 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 53.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Ragip Selimi ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 41.27 m<sup>2</sup> dhe 54.91 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 685, 686, 665, 705, 706, 723 dhe 724 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 188.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Xhevdet Duriqi ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 40.63 m<sup>2</sup>, 40.63 m<sup>2</sup>, 13.19 m<sup>2</sup>, 13.19 m<sup>2</sup> ku janë të vendosura kioskat nr. 256, 257, 258, 295, 296, 297, 303 dhe 304 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 210.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Kompania Profiti ;
  - Hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 13.19 m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr.255 Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 26.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Agim Beqiri ;

M.H.





- II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:
- b) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 13.09m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr. 621 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Amir Krasniqi duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 936 € - respektivisht (26€/36 muaj).
  - c) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 26.62m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 692 dhe 559 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Arben Sada duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 1872 € - respektivisht (52€/36 muaj).
  - d) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 29.62m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 691 dhe 660 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Habib Shala duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 2,088.00 € - respektivisht (58€/36 muaj).
  - e) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 27.40m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr. 701 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Gazmend Lepaja duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 1,944.00 € - respektivisht (54€/36 muaj).
  - f) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 56.38<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 689 dhe 690 Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Gazmend Lepaja duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 3.960.00 € - respektivisht (110€/36 muaj).
  - g) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 27.74 m<sup>2</sup>, 13.26 m<sup>2</sup> dhe 13,26 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 663, 664, 687 dhe 688 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Skender Rukovci duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 3816 € - respektivisht (106€/36 muaj).
  - h) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 26.93m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 683 dhe 684 Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Ragip Selimi duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 1,908.00 € - respektivisht (53€/36 muaj).
  - i) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 41.27 m<sup>2</sup> dhe 54.91 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 685, 686, 665, 705, 706, 723 dhe 724 Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Xhevdet Duriqi duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 6,768.00 € - respektivisht (188€/36 muaj).
  - j) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 40.63 m<sup>2</sup>, 40.63 m<sup>2</sup>, 13.19 m<sup>2</sup>, 13.19 m<sup>2</sup>, ku janë të vendosura kioskat nr. 256, 257, 258, 295, 296, 297, 303 dhe 304 Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Kompania Profiti duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 7,560.00 € - respektivisht (210€/36 muaj).
  - k) Për hapësirën afariste/tokën me sipërfaqe 13.19 m<sup>2</sup>, ku është e vendosur kioska nr. 255 - Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Agim Beqiri duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për tri (3) vitet e kaluara shumë prej 936.00 € - respektivisht (26€/36 muaj).
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.





## ARSYETIM

Bordí sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 30.07.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25167/2024, të parashtruar nga Konsoni M SH.P.K me të cilën ka kërkuar të marrë me qira përmes qiradhënies direkte lokalit nr.15 e cila është pronë e NSH Tregu, dhe gjendet në Tregun e Gjellbër tek RTK.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25428/2024, të parashtruar nga Amir Krasniqi, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr. 621, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25396/2024, të parashtruar nga Arben Sada, ku është kërkuar të marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.692 dhe 559 e cila menaxhohet nga NSH Tregu, dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25397/2024, të parashtruar nga Habib Shala, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.691 dhe 660, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25427/2024 dhe 25426/2024, të parashtruar nga Gazmend Lepaja, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr. 701,690 dhe 689, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25430/2024, të parashtruar nga Skender Rukovci, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.663,664,687 dhe 688, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25394/2024, të parashtruar nga Ragip Selimi, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.683 dhe 684, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25393/2024, të parashtruar nga Xhevdet Duriqi, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.685,686,665,705,706,723 dhe 724, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 19.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar një shkresë përmes emailit, të dërguar nga kompania Profiti, përkatësisht nga Drejtori i Operativës – Diar Mustafa. Në këtë shkresë është kërkuar që kompania të marrë me qira përmes procedurës së qiradhënies direkte hapësirat afariste me numrat 256, 257, 258, 295, 296, 297, 303 dhe 304, të cilat menaxhohen nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25404/2024, të parashtruar nga Agim Beqiri, ku është kërkuar marrja me qira përmes procedurës së qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.255. Kjo hapësirë është nën menaxhimin e NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas

M.H.





dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së asetëve, është tokë afariste përkatësisht treg.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet e mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira të NSh Tregu tek tregu i Gjellbër dhe tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
\_\_\_\_\_  
**Mentor Hyseni**  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/17

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 3 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 3.10.1 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 4.4 i kontratës së qirasë me nr. protokoli 53312/2024 të datës 04.09.2024, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e LAB-Oil Sh.P.K. që të fillohet me pagesa nga data 01.10.2024 për pikën e karburanteve në Zubin Potok, ashtu që obligohet pala qiramarrëse të paguajë nga momenti i dorëzimit të asetit në shfrytëzim.
- II. Aprovohet kërkesa e LAB-Oil Sh.P.K që të bëhet mbështetja financiare për rindërtim nga ana e AKP-së, në atë mënyrë që pala qiramarrëse lirohet nga pagesa e qirasë për dy (2) muaj (dhjetor 2024-janar 2025) si formë e mbështetjes financiare pasi që AKP nuk bën mbështetje financiare përmes mjeteve monterare.
- III. Aprovohet kërkesa për pezullim/mos-faturim të kontratës së qirasë për pikën e karburanteve në Zveçan, ashtu që si shkak i rindërtimit i jipet kohë palës qiramarrëse prej dy (2)muaj (tetor dhe nëntor 2024), nga data 29.09.2024, të bëjë funksionalizimin e objektit dhe të kryejë procesin e rindërtimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit dhe ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala LAB-Oil Sh.P.K ka lidhur kontratat e qirasë me NSH "Jugopetrol" për pikat e karburanteve në Zveçan dhe Zubin Potok më datë 04.09.2024 pas procesit të tenderimit publik të këtyre asetëve për qiradhënie. Si rrjedhojë më datë 15.09.2024 këto pika të karburanteve i ishin dorëzuar palës në shfrytëzim, pasi që ishte arritur të lirohen asetet nga gjësendet e ish-qiramarrësve në këto pika të karburanteve.

Më datë 10.10.2024 Agjencia ka pranuar kërkesën me nr. protokoli 4289 të qiramarrësit LAB-Oil Sh.P.K. përmes së cilit ka parashtruar disa kërkesa: 1) Për pikën e karburanteve për të cilën ka lidhur kontratë të qirasë në Zubin Potok të fillohet pagesa e qirasë nga data 01.10.2024; 2) Mbështetje financiare për rindërtim të pikës së karburantëve në Zveçan; 3) Udhëzime se si të veprojmë lidhur me procesin e rindërtimit të pikës në Zveçan; 3) Rrjedhja e qirasë në Zveçan të fillojë me rastin e funksionalizimit të pikës së karburanteve.

Vlen të ceket se më datë 29.09.2024 pas mesnate pika e karburanteve në Zveçan është sulmuar me eksploziv dhe nga ky sulm, kjo pikë e karburanteve ka pësuar dëme të mëdha në të cilat duhet të bëhen rregullime dhe të intervenohet në mënyrë që të funksionalizohet kjo pikë e karburanteve.

Sipas vlerësimit të Agjencisë, pezullimi dhe mos-faturimi i kontratës së qirasë për periudhën sa do të zhvilloheshin punimet në drejtim të funksionalizimit të kësaj pike të karburanteve është i arsyeshëm dhe kjo nuk do të paraqiste ngarkesë për palën qiramarrëse apo edhe rritje të borxhit ndaj NSH-së.

Për më tepër, pezullimi/mos-faturimi i kontratës së qirasë për muajt e cekur në dispozitiv të vendimit sa do të bëhen intervenimet është i arsyeshëm, për arsye se deri të mos-funksionalizimi nuk ka ardhur si pasojë e fajit të qiramarrësit por si pasojë e sulmit me eksploziv nga persona deri më tani të panjohur për organet e rendit.





Sa i përket kërkesës së parë që për pikën e karburanteve në Zubin Potok, të fillohet me pagesa nga data 01.10.2024, Bordi konsideron që kjo kërkesë duhet të refuzohet për arsye se duhet të vepohet sikurse në të gjitha rastet tjera të kontratave të qirasë, dhe që nga momenti i dorëzimit të asetit në shfrytëzim të faturohet secili qiramarrës, ashtu që është në anën e qiramarrësve të përcaktojnë kohën për të cilën ata do të zhvillojnë përgatitjet, përfshirë edhe punimet në funksionalizimin e këtyre pikave të karburanteve. Në këtë rast qiramarrësi, ka ditur për veprimtarinë që do të zhvillojë dhe ka pasur parasysh veprimet përgatitore që duhet të kryhen në mënyrë që të lëshohen këto pika të karburanteve në funksion, dhe është risk të cilin vet qiramarrësi duhet ta përcaktojë.

Sa i përket pikës së dytë të kërkesës që ka të bëjë me mbështetjen financiare për pikën në Zveçan e cila është dëmtuar nga sulmi me eksploziv, Bordi konsideron se kërkesa e LAB-Oil Sh.P.K aprovohet që të bëhet mbështetja financiare për rindërtim nga ana e AKP-së, në atë mënyrë që pala qiramarrëse lirohet nga pagesa e qirasë për dy (2) muaj si formë e mbështetjes financiare pasi që AKP nuk bën mbështetje financiare përmes mjeteve monetare dhe nuk bën investime të llojit të tillë dhe nuk është nën përgjegjësinë e qiradhënësit që të kryejë investimë në objektet e lëshuara me qira. Për më tepër, duhet të njoftohet LAB-Oil që NSh "Jugopetrol" nuk do të i njoh apo nuk do të bëjë kompensimin në të ardhmen të asnjë investimi të kryer në hapësirat e NSh "Jugopetrol".

Sa i përket kërkesës së tretë, në lidhje me udhëzimet se si të vepohet më procesin e rindërtimit të pikës në Zveçan, Bordi udhëzon qiramarrësin që gjatë funksionalizimit të objektit ti përmbahet projektit-strukturës që ka qenë para dëmtimit të pronës.

Sa i përket pikës së katërt të kërkesës, që ka të bëjë me kërkesën që rrjedhja e qirasë për pikën në Zveçan të fillojë nga koha e funksionalizimit të asetit, Bordi konstatoi se kërkesa e tillë duhet të aprovohet, ashtu që si shkak i rindërtimit i jipet kohë palës qiramarrëse prej dy (2)muaj, nga data 29.09.2024, të bëjë funksionalizimin e objektit dhe të kryejë procesin e rindërtimit.


Funksionalizimi i kësaj pike të karburanteve duhet të kërkohet të bëhet brenda kësaj periudhe në mënyrë që edhe për palën qiradhënëse, në këtë rast NSh "Jugopetrol" të mos krijohet fitimi i humbur, si pasojë e mos gjenerimit të të hyrave nga ana e qiradhënies. Brenda kësaj periudhe pala qiramarrëse do të jetë e obliguar të informojë Agjencinë se kur kthehet në funksionalizim pika e karburanteve në Zveçan dhe po ashtu një fakt i tillë duhet të verifikohet edhe nga ana e zyrtarëve të rastit në terren.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/18

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore/Asetin e paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjen Shoqërore/Asetin një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Kategoria	Komuna	Regjioni
1	PRN214	Agrokosova Commerce	Aset	Prishtinë	Prishtinë

- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetin e Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore/Asetin nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);
- III. Miratohet shitja e të gjitha aseteve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjen/asetin e propozuar për fillim të procedurave të likuidimit;
- IV. Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyn në fuqi me datë 8 nëntor 2024.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për tre ndërmarrjet/asetet me arsyetimet sikurse në vijim:


**PRN214 Organizata Punuese "Agrokosova Commerce" Export Import - Prishtinë** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, të sistemuar në KPS (SDR) i këtij aseti dhe nenit 5.1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 04/L-034, ky aset bie nën juridiksionin e AKP-së. Statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Divizioni i Zyrës Rajonale (DZR) të AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve, dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 30 korrik 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS1542/PRN214), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034. Zyra Rajonale nuk ka mundur të siguroj informata nëse kjo NSh ka asete të paluajtshme. Sipas informatave që ZR Prishtinë ka siguruar, kjo NSh e ka pasur një hapësirë afariste me qira në Pallatin e Rinisë, mirëpo për prona të saja nuk ka mundur të siguroj dokumente. Nuk ka informata se mbi këtë subjekt janë aplikuar masat e përkohshme. Në bazën e të dhënave në Njësinë për Regjistrimin e Ankesave në AKP, lidhur me këtë subjekt nuk ka kërkesa pronësore të paraqitura pranë kësaj njësie.

Duke marrë parasysh faktet si më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024

  
Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD/213/19

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti i Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRZ034 IFS Progres (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit me dy (2) kreditor të përfshirë, në shumë totale 13,373.11€ për pagesë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRZ034 IFS Progres (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblëdhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRZ034 IFS Progres (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.


Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD/213/20

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti i Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PEJ130 NHT Rugova (në likuidim) nga Rajoni i Pejës me tre (3) ose 6 kreditor të përfshirë, në shumë totale 4,938.13€ për pagesë.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e **PEJ130 NHT Rugova** (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e **PEJ130 NHT Rugova** (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.


Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/21

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet siç përshkruhet në certifikatën e pronësisë me nr. P-71611019-00001-166 me sipërfaqe totale prej 625 m2 dhe ngastra kadastrale P-71611019-00001-168 me sipërfaqe prej 400 m2 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet për pronën e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete do të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga prona e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastrat kadastrale P-71611019-00001-166 dhe P-71611019-00001-168 ZK Glllogjan që janë objekt i kësaj kërkesë sipas gjendjes faktike janë evidentuar si rrugë (infrastrukturë – rrugë e pakategorizuar), të cilat shërbejnë për lëvizjen e qytetarëve. Në këtë rast duke qenë se kategorizohet si rrugë, duke pasur parasysh edhe nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që "rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike".


Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike".


Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2024.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit







Nr. Ref. BD-213/22

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetë siç përshkruhet në certifikatën e pronësisë me nr. P-71611078-00082-19 me sipërfaqe totale prej 6744 m<sup>2</sup> dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet për pronën e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asetë do të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetë respektivisht nga prona e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra kadastrale P-71611078-00082-19 ZK Rosulë që është objekt i kësaj kërkesë sipas gjendjes faktike është evidentuar si rrugë, e cila shërben për lëvizjen e qytetarëve. Në këtë rast duke qenë se kategorizohet si rrugë, duke pasur parasysh edhe nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që "rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike".


